



KAZUS PENAL 2

Rrethanat e faktit

A. I dënuari **D**, banues në Kukës, ka vuajtur në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale ("IEVP"), Shënkoll, Lezhë dënimin e dhënë me vendimin penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, e cila e ka dekluaruar fajtor dhe dënuar me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim për kryerjen e veprave penale të:

- "Vjedhjes me armë" në bashkëpunim,
- "Plagosjes së rëndë me dashje" në bashkëpunim dhe
- "Mbajtjes pa leje të armëve lufttarake" të parashikuara nga nenet 140-25, 88/2-25 dhe 278/2 të Kodit Penal.

Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

I dënuari **D**, duke pretenduar se plotëson kushtet e nenit 64 të K.Penal, i është drejtuar Gjykatës së rrëthit gjyqësor Lezhë, me kërkesën për lirimin e tij me kusht.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka vendosur:

Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit **D**, si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Gjykata e Apelit Shkodër, ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.36, datë 28.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në këtë mënyrë:

- Pranimin e kërkesës së kërkuesit **D**.
- Urdhërohet liri me kusht i të dënuarit **D**, për pjesën e pavuajtur të dhënë me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, i lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë duke urdhëruar vënien në provë të të dënuarit për një periudhë prej 18 muajsh.
- Urdhërohet i dënuari të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Lezhë gjatë periudhës së provës.
- Urdhërohet liri i menjëhershëm i të dënuarit **D** nëse nuk ka masë sigurimi "Arrest në burg" për llogari të ndonjë procedimi tjeter penal ose dënim tjeter me burgim.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër ka paraqitur **rekurs Prokurori** pranë Prokurorisë së Apelit Shkodër, i cili kërkon ndryshimin e vendimit të mësipërm dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke paraqitur këto shkaqe:

- Liri me kusht nuk është një dispozitë detyruese, pasi ajo parashikon se i dënuari me burgim mund të lirohet me kusht nga vuajtja e dënitit vetëm për arsyen e çantë.

- Është e rëndësishme të përgjithësohet qëndrimi se "arsyet e veçanta" që justifikojnë lirimin e parakohshëm të të dënuarit duhet të kenë natyrë jetike dhe të burojnë nga shkaqe shëndetësore,

familjare ose shoqërore që diktojnë në mënyrë të detyrueshme vijimësinë e edukimit dhe rehabilitimit të të dënuarit pranë familjes, komunitetit apo nën kujdesin e nevojshëm mjekësor. Praktika gjyqësore ka zgjeruar kufjtë e vlerësimit dhe në drejtim të llojit të veprës penale, rrezikshmërisë së autorit dhe kohës së shkurtër të pavuajtur nga dënimit penal.

- Vepra penale e kryer e të dënuarit paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore; ne raport me masën e dënimit, të dënuarit i mbeten edhe 7 muaj dhe 12 ditë, periudhë kjo e konsiderueshme në raport me masën e dënimit.

- Shërbimi i Provës në raportin e përgatitur para gjykatës nuk shprehet apo më saktë nuk rekomandon lirimin e tij.



Jepni përgjigjen e arsyetuar të pyetjeve të shtruara për diskutim:

1. Në mungesë të një përkufizimi në Kodin Penal, çfarë do të kuptohet me shprehjen "arsye të veçanta" të parashikuar në nenin 64 të Kodit Penal, në gjykimin penal me objekt lirimin para kohe me kusht? (10 pikë)
 2. A mundet kjo gjykatë të marrë parasysh periudhën e sigurisë që është vendosur për të pandehurin nga gjykata që ka gjykuar themelin e çështjes? (10 pikë).
 3. Sa e rëndësishme është për gjykatën që trajton kërkesën në fjalë normalizimi i marrëdhënieve me viktimën dhe opinioni i kësaj të fundit? (10 pikë)?
- B. Ndërsa i dënuari **D**, vazhdonte të shlyente dënimin me kusht në Shqipëri, në Ministrinë e Drejtësisë vjen një kërkesë ekstradimi nga Republika e Italisë, pasi ndaj **D** ishte në fuqi një vendim përfundimtar dënnimi me burgim, për veprën penale të shitjes së narkotikëve, të kryer në bashkëpunim.

Në seancën gjyqësore ku u shqyrtua miratimi i kërkesës për ekstradim, mbrojtja e **D** pretendoi se ekstradimi nuk duhej të pranohej ose, të paktën, të shtyhej, pasi **D** kishte për të vuajtur pjesën e dënimit me kusht, për krimin e kryer në Shqipëri.

Jepni përgjigje të arsyetuar për pyetjet vijuese:

4. Cila do të jetë gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për ekstradim? (10 pikë)
5. Sipas mendimit tuaj, a duhej të pranohej kërkesa e Italisë për ekstradimin e **D**-së? Arsyetoni përgjigjen tuaj edhe në rastin e supozuar, sikur ndaj **D** të mos ishte dhënë vendim për lirimin para kohe me kusht. (10 pikë)



Përgjigjet

Pyetja 1

I. Ndërkohe që bazuar në teoritë aktuale mbi synimet e institutit të dënimit penal rezultojnë se kanë evoluar, nga rëndësia që i jepte ndëshkimit dhe parandalimit të veçantë dhe të per gjithshëm drejt synimeve për riedukimin, rehabilitimin dhe riintegrin në shoqëri të personit të dënuar, instituti i lirimt para kohe me kusht synon ndërprenjen e vuajtjes së mëtejshme të dënit me burgim në situatën kur arrihet të provohen një sërë arsyesh e rrethanash, të provuara qartësisht dhe konkretisht dhe që evidentojnë faktin se dënim i burg i vuajtur, tashmë ia ka arritur qëllimit të redukimit të personit të dënuar dhe ai ka mundësinë të riintegrohet në shoqëri.

Bazuar në nenin 64 të K.Penal dhe Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.2/2015 evidentohet se nuk ka një listë shteruese të arsyeve të veçanta që gjykata duhet të verifikojë për të pranuar kërkesën dhe ligji e ka lënë në dorë të gjykatave vlerësimin e tyre të cilat, domosdoshmërisht duhet të lidhen me qëllimin e institutit. Sipas Gjykatës së Lartë ato janë rrethana konkrete dhe të provuara që çojnë në përfundimin se dënim i kryer e ka arritur qëllimin e riedukimit dhe se vuajtja e mëtejshme e dënit në burg nuk është e nevojshme. Këto rrethana tregojnë qartë se personi është i gatshëm për t'u riintegruar në shoqëri. Ato duhet të lidhen me faktorë i përkasin qasjes së personit dhe jo faktorëve të jashtëm. Kjo qasje e tij duhet të jetë në raport me ambientin, veprën penale, viktimen, familjen dhe shoqërinë në përgjithësi.

Në këtë vështrim, praktika gjyqësore ka theksuar disa çështje apo elemente që gjykatat duhet të vlerësojnë në shqyrtimet e kërkesave me objekt lirim me kusht:

- Natyra e veprës penale të kryer është një nga elementët më të rëndësishëm që duhet të merret parasysh nga ana e gjykatës në shqyrtimin e kërkesës për lirim me kusht.
- Qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimes apo familjes së viktimes është elementi i dytë që ligji parashikon për t'u trajtuar në raportin e Drejtorit të IEVP-së. Pendimi i të dënuarit duhet të rezultojë nga të dhëna objektive.
- Ndonjë veprë e mëparshme penale, e kryer prej të dënuarit.
- Gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, kjo pasi qëllimi i ligjvënësit nuk është neutralizimi i të dënuarit, por riintegrimi i tij në shoqëri.
- Dinamika e sjelljes së të dënuarit në IEVP është, së fundmi, një element kyç në lidhje me provën e riedukimit të të dënuarit, për të verifikuar nëse gjatë periudhës së vuajtjes së dënit, sjellja e tij ka qenë e tillë sa për të çuar drejt përfundimit se i dënuari vërtet ka treguar pendim, duke u sjellë me korrektesë.
- Raporti i Shërbimit të Provës, që duhet të përmbajë (i) kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe (ii) planet konkrete, për të mundësuar riintegrin e plotë të tij pas lirimit.
- Kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe verifikimi i planeve konkrete të të dënuarit për të mundësuar riintegrin e plotë të tij pas lirimit,

Pyetja 2

2. Instituti i periudhës së sigurisë të parashikuar në nenin 65/a të K.Penal nënkupton një periudhë kohore përgjatë vujtjes së një dënim me burgim brenda së cillës, i dënuari nuk mund t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për lirimin para kohe me kusht. Kjo periudhë mund të caktohet nga gjykata që ka gjykuar themelin e cështjes dhe që përfshin përiudhën që nga koha kur lind e drejta për kërkesën për lirimin para kohe me kusht deri në vuajtjen e plotë të dënitit.

Në vlerësimin e kërkesës për lirimin para kohe me kusht, gjykata që shqyrton kërkesën është e detyruar të marë parasysh periudhën e sigurisë së vendosur nga gjykata për të pandehurin në gjykimin në themel. Mosplotësimi i periudhës së sigurisë i caktuar nga gjykata që ka shqyrtuar në themel çështjen përbën shkak përrëzimin e kërkesës.

Pyetja 3

3. Kolegjet e Bashkuara, në Vendimin nr.2/2015 të saj kanë argumentuar se normalizimi i marrëdhënive me viktimën e përrjedhojë opinioni i saj nuk është kusht i domosdoshëm për pranimin e kërkesës për lirimin e me kusht.

Normalizimi i marrëdhënive vlerësohet si element në favor të kërkuesit gjatë shqyrtimit të kërkesës së bërë prej tij.

Në këtë aspekt, vlerësohen me kujdes të gjitha përpjekjet konkrete që ka bërë i dënuari për normalizimin e marrëdhënieve me viktimën duke evidentuar përpjekjet për të kërkuar falje, përzëvendësimin e dëmit të shkaktuar apo zhdukur/pakësuar pasojat e veprës penale.

Pyetja 4

4. Në bazë të nenit 493/6 të K.P.P, gjykata që ka shqyrtuar masën shtrënguese të kërkuar në funksion të ekstradimit është kompetente për shqyrtimin dhe të kërkesës për ekstradimin e personit, ndërkohë që, nen 494/3 i K.P.K rregullon kriteret e përcaktimit të kompetencës së gjykatës që shqyrton masën shtrënguese.

Sipas kësaj të fundit, kriteret për përcaktimin e kompetencës janë sipas rradhës; vendbanimi i personit, vendqëndrimi apo vendi i banesës ose vendi ku personi gjendet. Nëse kompetenca nuk mund të përcaktohet mbi sa me sipër, kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në rastin konkret, gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për ekstradim do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridikzionit të Përgjithshëm Kukës, bazuar në të dhënën e paraqitur në kazus mbi vendbanimin e tij.

Pyetja 5

5. Pranimi ose jo i kërkesës për ekstradim nuk kushtëzohet nga situata procedurale e personit në rapport me një procedim për një vepër penale tjeter, të ndryshëm nga ai për të cilin kërkohet ekstradimi.

Ndryshimet e bëra në nenin 491 të K.P.P me ligjin nr.41/2021 kanë shfuqizuar pikën "c" të tij ku kushtëzohej pranimi ose jo i kërkesës nga një procedim tjeter në Shqipëri.

Gjkata e shqyrton kërkesën në raport me kushtet përcaktuara në nenin 491 të K.P.P dhe vendos lejimin ose jo të ekstradimit. Nëse gjykata disponon moslejimin e ektradimit Ministri i Drejtësisë nuk mund të disponojë të kundërtën. Nëse gjykata disponon për lejimin e ektradimit është në diskrecion të Ministrit të Drejtësisë nëse efektivisht do të disponojë për dorëzimin e personit autoriteteve të shtetit kërkues.

Kërkesa për ektradimin e D duhet të pranohet si në rastin konkret dhe në rastin e supozuar se ndaj tij nuk do të ishte dhënë vendimi për lirimin para kohe me kusht, nëse gjykata vlerëson se nuk ka rrëthana të tjera nga ato që parashikon nen 491 i K.P.P, që ndalojnë ektradimin.

Në rastin konkret gjejnë zbatim parashikimet e nenit 500 të K.P.P, për pezullimin e ektradimit nga Ministri i Drejtësisë, si dhe parashikimet e nenit 41 të Ligjit nr.10193/2009, të ndryshuar, për ektradimin e shtyrë. Kjo, nënkupton ekzekutimin e ektradimit/dorëzimin e personit pas përfundimit të procesit penal apo vuajtjes së dënimit për në vepër tjeter penale që ndiqet nga autoritetet shqiptare.

Gjkata e Lartë në praktikën e saj (edhe para ndryshimeve të KPP) ka vlerësuar se procedura e ektradimit pasiv, karakterizohet nga dy faza: 1. faza e garancive juridikionale, në të cilën gjykatat vlerësojnë plotësimin e kushteve dhe kriterieve që legjitimojnë kërkesën për ektradim pasiv, pra për dorëzimin e personit për të cilin kërcohët ektradimi; 2. faza administrative, në të cilën, në rast të një vendimi gjyqësor në favor të ektradimit, Ministri i Drejtësisë ka diskrecionin për të vendosur lidhur me pranimin përfundimisht të kërkesës për ektradim të paraqitur nga autoritetet gjyqësore të shtetit të huaj duke vlerësuar sipas rastit oportunitetet politiko - administrative.

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Agjela Boçka".

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Albina Boçka".

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Albina Boçka".

1997

CISTRAL